

Hapet thirrja për bursa në Programin Erasmus + në Universitetin Staffordshire, Angli për mobilitete në kuadër të programit Erasmus për stafin akademik me kohë të plotë të UT për trajnim, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021 - 2022.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Staffordshire, në kuadër të programit Erasmus për stafin akademik me kohë të plotë të UT për trajnim për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

<http://www.staffs.ac.uk/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për trajnim;

Fushat:

- Financë;
- Kontabilitet;
- Ekonomiks;
- Biznes / Manaxhim;

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik për trajnim (15 + 2 ditë);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (180 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik për trajnim:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi;
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze;
- Vetëdeklarim nëse ka kryer më parë një mobilitet Erasmus+ apo jo;
- Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit te Mobilitetit klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: 07 Qershor 2022

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!